




Pranuar / Dorezuar Prenje / Prodato Received / Delivery	08-02-2024	9	viti god year
Organ / Shesht Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHAC	794/2024		1/9



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr. 1554/23**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga:** Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1554/2023, të datës 21.12.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.02.2024, mori këtë:

**V E N D I M**

**Hedhet poshtë si e papranueshme ankesa me numër A.nr.1554/2023, e datës 21.12.2023, e parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Ankuesi (*tani e tutje referuar si ankuesi*), më datë 21.12.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 14.12.2023 të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për anulimin e procedurës së konkurrimit për pozitën Zyrtar për Pasuri.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.12.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, me datë 04.01.2024, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me provat ndërlidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 7593/2023 të datës 21.12.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 14.12.2023 për anulimin e procedurës Zyrtar për Pasuri në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; komunikimet mes ankuesit dhe organit të

punësimin përmes E-mailit të datës 16.01.2023; 17.01.2023; 26.04.2023 ; 27.03.2023 dhe 18.04.2023; Kërkesën e datës 08.11.2022 e parashtruar nga ankuesi përmes avokates për Këshillin Prokurorial të Kosovës; Njoftimin e datës 23.09.2022 për kandidatë që kanë hyrë në testin me shkrim për pozitën Zyrtar për Pasuri, se procesi pezullohet deri në zgjidhjen e çështjen paraprake; Njoftimin e datës 12.09.2022 i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë; Kopjen e konkursit të datës 15.02.2022 të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të nakuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.12.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 04.01.2024 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës si: Kopjen e konkursit të datës 22.08.2022; E-mailin e datës 12.09.2022 –njoftimin për mbajtjen e testit me shkrim; Dëshminë për dorëzimin e aplikacionit me nr.878 të datës 25.08.2022; Aplikacionin për punësim i datës 25.08.2022 për Certifikatën me nr.7401/22 të datës 24.08.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj; Diplomën e datës 31.08.2018 me nr.00358/3 e lëshuar nga Universiteti Metropolitan Tirana; Diplomën e noterizuar LRP.nr.3618/2018; Vendimi me nr.6-3942 të datës 18.10.2018 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Referencën e datës 24.08.2022 e lëshuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj; Vërtetimin e muajit janar 2022 me të cilin dëshmohet se ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune në Fabrikën e bukës Ferizaj prej datës 01.12.2014 deri më 01.12.2017 në cilësinë e menaxherit; Certifikatë e datës 14.09.2011; Akt emërimit të datës 03.07.2019; Certifikatë e datës 05.06.2014 e lëshuar në Tiranë nga Universiteti Metropolitan-Fakulteti Ekonomik; Kontratë pune për kohë të caktuar e datës 01.12.2014 e lëshuar nga Fabrika e bukës Ferizaj; Lista përfundimtare e përzgjedhjes së listës së ngushtë e datës 09.09.2022; Njoftimi i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë 12.09.2022 lidhur me konkursin Zyrtar i Pasurisë në Këshillin Prokurorial të Kosovës; Raport lidhur me listën e ngushtë për pozitën Zyrtar për Pasuri e datës 12.09.2022; Vendimin DKSKPK nr.410/2022 i datës 06.09.2022 për themelimin e komisionit përzgjedhës për shërbimin civil të Kosovës nga U.D. Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK; Vendimin DKSKPK nr.555/2022 i datës 25.11.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimi me nr.410/2022 i datës 06.09.2022 për themelimin e komisionit përzgjedhës për shërbimin civil të Kosovës nga U.D. Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK; Vendimin DKSKPK nr.565/2022 i datës 29.11.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimi me nr.555/2022 i datës 25.11.2022 për themelimin e komisionit përzgjedhës për shërbimin civil të Kosovës nga U.D. Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK; Vendimin DKSKPK nr.524/2022 i datës 06.12.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimi me nr.565/2022 i datës 29.11.2022 për themelimin e komisionit përzgjedhës për shërbimin civil të Kosovës nga U.D. Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK dhe Njoftimin e datës 23.09.2022 për pezullimin e konkursit për pozitën Zyrtar për Pasuri.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e parakohshme , *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 22.08.2022 ka publikuar konkursin për pozitën “Zyrtar për Pasuri” në Divizionin për Shërbime të Përgjithshme, një pozitë. Konkursi ka qenë i hapur për aplikimin nga data 22.08.2022 deri më 05.09.2022, e në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesi duke u përfshirë në listën e ngushtë, gjegjësisht për të vazhduar me fazat e mëtejme të konkursit.

Tutje nga shkresat e lëndës rrjedhë se ankuesi i është nënshtruar testimit me shkrim, duke grumbulluar gjithsej 83 pikë, ndërsa më datë 23.09.2022 Sekretariati i Këshillit Prokurorial i Kosovës kishte publikuar njoftimin me të cilin ishte pezulluar konkursi i datës 22.08.2022 për pozitën Zyrtar i pasurisë, duke u bazuar në nenin 85 të Ligjit Nr.05/L-031për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Më datë

18.11.2023, organi i punësimit kishte hequr pezullimin e kësaj procedurë të rekrutimit me pretendimin që të vazhdohej me tutje lidhur me konkurrimin, mirëpo, sipas shkresave të lëndës rrjedh së Komisioni i pranimit i themeluar sipas Vendimit DPSKP/nr.410/2020 të datës 06.09.2022, nuk kishte mundur të vazhdoj më punën pasi që anëtari i caktuar kishte dhënë dorëheqje nga pozita e tij e Administratorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ku me pastaj, Komisioni i vlerësimit kishte pësuar disa herë plotësime dhe ndryshime më anëtare, dhe si pasojë anëtarët e zëvendësuar nuk kanë vazhduar procedimin e mëtejme të këtij procesi rekrutimi, dhe rrjedhimisht me datë 14.12.2023, SKGJK-ja ka shpallur njoftimin për anulim të konkursit në fjalë për shkak të kalimit të afateve ligjore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se: pezullimi i konkursit është bërë qëllimisht, duke i mohuar të drejtën për punësim pasi që ankuesi ishte kandidati i vetëm dhe më i suksesshëm në testin me shkrim. Shton së procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar i Pasurisë, është përcjell me shkelje ligjore, si pasojë e neglizhencës, mosveprimit dhe ushtrimit të diskrecionit në mënyrë të kundërligjshme nga SKGJK-ja. Tutje sipas ankuesit ankesa e palës së tretë nuk përbenë çështje paraprake, kështu që pezullimi i procedurës ka qenë i kundërligjshëm. Propozon që Këshillit të aprovoj ankesën dhe të anuloj Njoftimin e datës 14.12.2023 të SKGJK-së dhe të detyroj të njëjtin që procedura e rekrutimit të vazhdoj me intervistën me gojë.

Duke ju referuar nenit 99 paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i aplikueshëm nga data 25.09.2023, ku përcaktohet se: *Procedurat e rekrutimit, të disiplinës apo të ankesave të filluara dhe të papërfunduara në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar çështjet përkatëse, e duke qenë së procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar i Pasurisë në SKGJ ka filluar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, trajtimi i kësaj çështje në procedurë të ankesës do të behët në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*

Referuar konstatimit si me sipër, e duke u bazuar në nenin 81 Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i cili ka përcaktuar se: *"1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, si dhe nenin 4 paragrafi 1 dhe nenin 9 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave që përcaktojnë së: neni 4.1 "Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës.... Neni 9: kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditësh."* Kolegji konstaton së ankuesi kundër anulimit të konkursit për pozitën "Zyrtar i pasurisë", fillimisht duhej të parashtronte ankesë të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të organit të punësimit në këtë rast të Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, e më pastaj, në rast të pakënaqësisë me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, mund të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. Andaj, meqenëse bazuar në provat materiale të çështjes nuk vërtetohet fakti se ankuesi ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës së brendshme, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit A.nr.1554/2023 është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1554/2023

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Personelit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK- së.

